



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR FIER

Nr. 846 Prot.

Fier, më 19.09 . 2025

SHPALLJE Nr. 3

E VENDEVE TË LIRA PËR PUNONJËS TË NJËSISË SË SHËRBIMIT PSIKO-SOCIAL NË INSTITUCIONET PUBLIK TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR (IPAP) NË ZVAP NË VARËSI TË DRAP FIER

Në zbatim të Ligjit nr.69 / 2012 “ Për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, VKM nr.99, datë 27.02.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”, Urdhërit nr.313 datë 20.10.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e njësisë së shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psiko-social”, i ndryshuar, shpall vendet e lira të punës për punonjës në njësinë e shërbimit psiko-social (psikolog/punonjës-social) në institucionet publike të arsimit parauniversitar IPAP, në ZVAP-të në varësi të DRAP Fier.

I. Kriteret për t’u punësuar në shërbimin psiko-social

A. Kërkesat e përgjithshme që duhen plotësuar për punësim në pozicionet e mësipërme janë:

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi për të vepruar;
3. Të jetë në kushte shëndetësore të mira për të kryer detyrat përkatëse;
4. Të mos jetë dënuar për vepra penale dhe të mos ketë proces penal të hapur në prokurori apo gjykatë;
5. Të mos ketë marrë më parë masë largimi nga punët e mëparshme dhe të mos ketë masa të tjera administrative apo vërejtje në fuqi.

B. Kërkesat e veçanta që duhen plotësuar për punësim në pozicionet e mësipërme janë:

1. Kandidati duhet të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës;
2. Të jetë pajisur me diplomën e ciklit të dytë, në fushën përkatëse;
3. Njohuri bazë në kompjuter;
4. Zotërimi i gjuhëve të huaja përbën avantazh (dëshmi, certifikata);
5. Aftësi komunikuese dhe punë në grup.

II. Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

A. Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

1. Përshkrimi i edukimit dhe i karrierës profesionale- jetëshkrimin (Curriculum vitae), sipas shtojcës 3 të Urdhërit nr.313, datë 20.10.2020 (e detyrueshme);
2. Kërkesë për punësim në zyrën arsimore që dëshiron për pozicionin psikolog / punonjës social (e detyrueshme);
3. Raport mjeko-ligjor i tri muajve të fundit (i detyrueshëm);

- 
4. Deklaratë për verifikimin e vërtetësisë së dokumentave të paraqitura nga kandidati sipas shtojcës 4 të Urdhërit nr.313 datë 20.10.2020 (e detyrueshme);
 5. Formular vetëdeklarimi i gjendjes gjyqësore sipas shtojcës 5 të Urdhërit nr.313 datë 20.10.2020 (e detyrueshme);
 6. Fotokopje e librezës së punës e noterizuar (nëse ka);
 7. Kopje e njehsuar me origjinalin e diplomës/diplomave, vërtetimit/listës së notave të studimeve të larta (cikli i parë, cikli i dytë dhe diplomat e integruara të ciklit të dytë) ose të barazvlefshme me këto sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi (për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit (e detyrueshme);
 8. Listë notash e noterizuar për nivelin bachelor dhe master (e detyrueshme);
 9. Leje për ushtrimin individual të profesionit (licencë);
 10. Kopje e njehsuar me origjinalin e arsimit shtesë dhe listës së notave si dhe certifikatave për gjuhët e huaja apo kualifikime të ndryshme;
 11. Fotokopje e kartës së identitetit ose certifikatë personale (e detyrueshme);
 12. Dëshmi penaliteti (e detyrueshme);
 13. Nëse është i punësuar, vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi ose vetëdeklarim në rastin kur nuk është i punësuar (e detyrueshme).

14. Kualifikimi dhe vlerësimi i kandidatëve do të bazohet edhe në kreun VII, pika 4 të Urdhërit nr. 313 datë 20.10.2020, të ndryshuar.

B. Dokumentacioni i aplikimit dorëzohet nëpërmjet shërbimit postar në DRAP Fier brenda afatit 19.09.2025- 24.09.2025.

- III. Vlerësimi i dokumentacionit të kandidatëve për psikolog /punonjës social do të kryhet nga komisioni në datën 25.09.2025.
- IV. Rezultatet paraprake të vlerësimit të dokumentacionit do të shpallen në faqen zyrtare të DRAP Fier në datë 26.09.2025.
- V. Ankimimet brenda datës 29.09.2025.
- VI. Rezultatet përfundimtare do të shpallen në datën 29.09.2025.
- VII. Bazuar në renditjen përfundimtare, DRAP Fier do të ndjekë procedurat e emërimit sipas përcaktimeve të Urdhërit nr.313/2020 i ndryshuar.
- VIII. Vendet e lira sipas ZVAP-ve përkatëse bashkëlidhur.

DREJTORI

Zaira Gjika



LISTA E VENDEVE TË LIRA PËR PROCEDURËN E KONKURIMIT PËR SHPS

19.09.2025

Nr	Drap	Zvap	Shkolla	Psikolog/P/So	Kontrata me afat/ pa afat
	Fier	Fier	Avdi Metaj	P.Social	Me afat
2	Fier	Fier	Trifon Prifti	P.Social	Me afat
3	Fier	Fier	Jovan Ndreko	Psikolog	deri 01.06.2026
4	Fier	Patos	Zhani Ciko	Psikolog	Me afat
5	Fier	Mallakastër	Beslidhja	P.Social	Me afat
6	Fier	Mallakastër	Gjok Doçi	Psikolog	Me afat
7	Fier	Divjakë	SHB GRABIAN	Psikolog	deri në 23.04.2026
8	Fier	Divjakë	SHB Çermë Shkumbin	P.Social	deri në 01.01.2026
9	Fier	Vlorë-Himarë	Pano Nikolla Memrëka	Psikolog	Me afat
10	Fier	Vlorë-Himarë	Qazim Pali	Psikolog	Me afat
11	Fier	Selenicë	Qani Nuredini	Psikolog	Me afat
12	Fier	Selenicë	Eqerem Beqiri	P.Social	Me afat
13	Fier	Tepelenë-Memaliaj	Nimete Progonati	Psikolog	Me afat
14	Fier	Përmet-Këlcyrë	Sejfulla Maleshova	Psikolog	Me afat
15	Fier	Përmet-Këlcyrë	Lumo Pavari	P.Social	Me afat
16	Fier	Gjirokastrë	Koto Hoxhi	P.Social	deri 30.06.2026
17	Fier	Gjirokastrë	Muhamet Gjollësja	Psikolog	Me afat
18	Fier	Gjirokastrë	Asim Zeneli	Psikolog	Me afat
19	Fier	Gjirokastrë	Avni Rustemi	P.Social	Me afat
20	Fier	Sarandë	Hasan Tahsini	Psikolog	deri në 25.02.2026
21	Fier	Finiq-Dropull	SHB Dervican	Psikolog	Me afat
22	Fier	Profesionale	Petro Sota	Psikolog	Me afat